

VENDIM
Nr.952, datë 24.11.2010

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË ZHVILLOJË
PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT “NDËRTIMI I RRUGËS KOMUNA E
PARISIT - RRUGA E RE, TIRANË - ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, si autoritet kontraktor, të zhvillojë procedurën e prokurimit, me objekt “Ndërtimi i rrugës Komuna e Parisit - Rrugë e Re, Tiranë - Elbasan”, brenda vitit 2010.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha